



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.59, Datë 06.03.2023

PËR  
“NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.157, DATË 27.06.2022, TË KËSHILLIT “PËR  
PRAKTIKËN PROFESIONALE TË KANDIDATËVE PËR MAGJISTRATË TË  
SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS””

Bazuar në nenet 14 dhe 33 të ligjit Nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Në vendimin Nr.157, datë 27.06.2022, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, bëhet ndryshimi si më poshtë:
  - Në aneksin 1, shtohet si prokuror udhëheqës zoti Arens Çela, drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
  - Në aneksin 4, zonja Silvana Lule, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, zëvendësohet me zotin Arens Çela, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, si dhe zonja Armida Moçka prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, zëvendësohet me zotin Elio Mazreku, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
3. U shpall në Tiranë, sot më 06.03.2023.

KRYETARI

Alfred Balla

